

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Begaj takohet me homologun Mohamed bin Zayed, vizita e parë e një presidenti shqiptar në Emiratet e Bashkuara Arabe
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/begaj-vizite-zyrtare-ne-emiratet-e-bashkuara-arabe-t-akon-presidentin-mo-i586075
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 15:47:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:10:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d1515a0f01ced23933ac0b8269c1d5ae83c9be66094e4ee63736481e64958b00
TEKSTI	0518c922927c82811ed8f28aff43cc6b3350cf2f71ea247870b7aac883a71f41
PAMJA	5df78c2b1f6f18ea84305015ab258ed8ed1dfab76b4565de35c6eaba491aa329

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	53babc38b024bf52048086abfe351eb7051571f19e993a1185a59dd87006de9a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c5c495e1993bed01ae9e3c22701c0f0e7f56228ef65729414d07abaefa87f787
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/53babc38b024bf52048086abfe351eb7051571f19e993a1185a59dd87006de9a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e [Vendimi i 16 shtatorit për ish-kreret e UCK-se, zbulohet kush do ta përfaqësojë Qeverinë e Kosovës në Hagë](#) Skocia, Uelisi dhe Irlanda e Veriut kerkojne shkeputje nga Brit fundit

Begaj takohet me homologun Mohamed bin Zayed, vizita e parë e një presidenti shqiptar në Emiratet e Bashkuara Arabe



14 Shtator 2026, 18:10Politika TEMA



Presidenti Bajram Begaj zhvilloi vizitën e parë zyrtare të një kreu të shtetit shqiptar në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku u prit nga Sheiku Mohamed bin Zayed Al Nahyan. Takimi rikonfirmoi angazhimin e dy vendeve për forcimin e partneritetit politik dhe ekonomik, si edhe për zgjerimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët.

Gjatë bisedimeve në Abu Dhabi, Begaj falënderoi Emiratet për mbështetjen që i kanë dhënë Shqipërisë dhe shqiptarëve në momente të vështira, duke kujtuar ndihmën gjatë luftës në Kosovë, pas tërmetit të vitit 2019 dhe pas sulmit kibernetik të vitit 2022.

Një nga temat kryesore të takimit ishte bashkëpunimi ekonomik. Presidenti u shpreh se hapja e Ambasadës së Emirateve të Bashkuara Arabe në Tiranë do t'i japë një shtysë të re marrëdhënieve mes dy vendeve, ndërsa ftoi investorët emirates të zgjerojnë praninë e tyre në Shqipëri, veçanërisht në infrastrukturë, energji, inovacion, turizëm dhe sektorë të tjerë strategjikë.

Dy presidentët diskutuan edhe për zhvillimet rajonale e ndërkombëtare, duke vlerësuar bashkëpunimin mes dy vendeve në mbështetje të paqes, sigurisë dhe zhvillimit.

Gjatë vizitës në Abu Dhabi, Begaj zhvilloi takime edhe me Princin e Kurorës, Sheikh Khaled bin Mohamed bin Zayed Al Nahyan, si dhe me Zëvendës-presidentin e Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Mansour bin Zayed Al Nahyan.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Braçe i ashpër me KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Në thesar nuk fut dot dorën kushdo, s'i vë dot kush shkelmin parave të shqiptarëve](#)

16:00 Politika

[VIDEO/ "Tani në Fier demokrat jam edhe unë, krah Gaz Bardhit"- Gjergj Luca ironizon Berishën: Nuk hoqe dore nga intrigat bolshevike](#)

15:30 Politika / 5 komente

[Plarent Ndreca: Nuk ka arsye që Veliaj të mbahet në paraburgim, gjykatat e tre shkallëve nuk treguan kujdesin e duhur](#)

15:20 Politika / 8 komente

[Debat i pagave të magjistratëve, analisti: Kërkesa e gjyqtarëve e tepruar, reforma në drejtësi duhet riparë](#)

14:50 Politika / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.